

Feja

Zvicra është tradicionalisht një vend i krishterë. Sado sot këtu jetojnë edhe shumë njerëz, që kanë një fe tjetër. Në Zvicër mbretëron liria fetare, dhe shkollat shtetërore janë neutrale në lidhje me fenë.

Feja dhe shteti

Zvicra tradicionalisht është e karakterizuar nga feja e krishterë. Kantonet përcaktojnë marrëdhëniet midis fesë dhe shtetit. Si shumica e kantoneve gjermano-zvicerane, kantoni Basel-Stadt pranon disa shoqëri fetare si institucione publiko-juridike. Kjo do të thotë, që shteti atyre iu bart disa të drejta. Për shembull ata mund të marrin tatime prej pjesëtareve të tyre. Këto shoqëri fetare janë të pranuar në kantonin Basel-Stadt si institucione publiko-juridike: kisha ungjillore e reformuar, kisha romako-katolike, kisha kristjano-katolike si dhe bashkësia Izraelite. Disa komunitete të tjera janë të pranuar nga kantoni. Ata organizohen sipas të drejtës private.

Shoqëritë fetare në kantonin Basel-Stadt

Rreth një e treta e popullsisë së Bazelit janë anëtarë në një prej katër komuniteteve me pranimin publiko-juridik. Veç kësaj ka shumë komunitete të tjera fetare, për shembull lëvizje myslimane, hinduistike, budistike ose lëvizje më të reja. Rreth gjysma e banoreve dhe banorëve nuk bëjnë pjesë në një komunitet fetar.

Liria fetare

Kushtetuta e Zvicrës garanton lirinë fetare. Do të thotë: Çdo njeri lejohet të vendosë vetë, se çfarë bindje fetare ai ka. Çdo njeri lejohet të shprehë dhe të përhapë bindjen e vet. Askush nuk lejohet të detyrojë një tjetër të hyjë në një shoqëri fetare apo të marrë pjesë në veprime fetare. Personat lejohen të mblidhen për të ushtruar rituale dhe festa fetare. Nuk lejohet diskriminimi i njerëzve për shkak të fesë apo besimit të tyre.

Feja dhe shkolla

Shkolla e detyruar është neutrale çfarë i përket fesë. Sado, tema fetare kanë vendin e vet në mësim. Në ciklin e ulët ekziston lënda "Natyra, njeriu, shoqëria". Këtu bëhet fjalë për mënyra të ndryshme jetese dhe kultura të ndryshme. Veç kësaj lënde ekziston mësimi konfesional fetar, ku fëmijët mund të marrin pjesë vullnetarisht. Në ciklin e lartë ekziston lënda "Etika, fetë, komuniteti". Është një lëndë e obliguar. Këtu nxënëset dhe nxënësit mësojnë aftësi të rëndësishme, që u duhen për një jetë me kultura, feja dhe botëkuptime të ndryshme si dhe me përfytyrime të ndryshme vlerash. Për fëmijët me drejtime të tjera besimesh komunitetet fetare ofrojnë pjesërisht mundësi për mësim jashtë shkollës.



Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/kantoni-basel-stadt/feja